VENDIM
Nr. 50, datë 5.2.2014

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR PARANDALIMIN DHE SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA E TË PLANIT TË VEPRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 185/2013 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit, sipas dokumentit bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kritereve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të qeverisjes qendrore, si pjesë e strategjisë.
3. Ngarkohet Ministria e Financave për ngritjen e njësisë së posaçme të administrimit e të monitorimit të detyrimeve të prapambetura dhe nxjerrjen e udhëzimeve në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

STRATEGJIA
PËR PARANDALIMIN DHE SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA
DHE PLANI I VEPRIMIT

LISTA E AKRONIMEVE

APP - Agjencia e Prokurimeve Publike
DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
KPD - Komiteti i Detyrimeve të Prapambetura
KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM - Këshilli i Ministrave
MF - Ministria e Financave
NPA - Nëpunësi i parë autorizues, sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Financave
Nëpunës autorizues-sekretari i përgjithshëm në ministrinë dhe institucionet qendrore, drejtuesit e institucioneve të vartësisë
Nëpunës zbatues-drejtuesi për financave në institucion
TVSH - Tatimi mbi vlerën e shtuar
SPSDP/SPSD - Strategjia i parandalimit dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura
SIFQ - Sistemi informatik financiar i qeverisë

PËRMBLEDHJE

Përmbajtja e dokumentit: Kjo strategji përcakton rrugën që do të ndjekë qeveria shqiptare për të paguar detyrimet financiare të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore, si dhe masat që do të ndërmerren për të parandaluar krijimin e detyrimeve financiare të prapambetura në të ardhmen për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Objektivat e strategjisë:

Objektivi 1. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura në mënyrë të saktë, transparente dhe të besueshme.

Objektivi 2. Forcimi i disiplinës financiare për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen.

Aktorët kryesorë: rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e strategjisë:

Ministri i Financave si udhëheqës dhe monitorues i procesit.

Titullarët e institucioneve të qeverisjes qendrore për sigurimin e verifikimit të plotë të saktësisë së

pretendimeve për detyrime të pashlyera.

Nëpunësi i parë autorizues për organizimin dhe ndjekjen e procesit.

Nëpunësit autorizues dhe zbatues për identifikimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura të institucioneve që mbulojnë, si dhe raportimin e tyre në degët e thesarit dhe te nëpunësi i parë autorizues.

Komiteti i Detyrimeve të Prapambetura për miratimin përfundimtar të detyrimit për t'u paguar dhe ndjekjen e shlyerjes së detyrimit financiar të prapambetur.

Agjencia e Prokurimit Publik për t'u siguruar që përpara nisjes së procedurave të prokurimit, çdo urdhër prokurimi i autoriteteve kontraktore të jetë i vulosur nga degët e thesarit ku ushtron aktivitetin njësia e qeverisjes së përgjithshme. Kjo provon që çdo proces tenderimi bazohet në fonde buxhetore të miratuara dhe në dispozicion të njësisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për identifikimin dhe vlerësimin e pretendimeve për rimbursimin e TVSH-së dhe tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për detyrimet e prapambetura në lidhje me pretendimet e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar.

Gjatë procesit, Ministria e Financave do të mbikëqyret nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, bazuar në një marrëveshje institucionale, si dhe nga një audit ndërkombëtar për të siguruar procesin dhe publikun mbi transparencën dhe paanësinë e kryerjes së procedurave të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

Shlyerja e detyrimeve financiare të prapambetura është parashikuar të përfundojë brenda tri viteve të ardhshme, që përkon me fundin e vitit 2016.

A. Hyrje dhe të dhëna paraprake

1. Në shtator 2013, qeveria filloi vlerësimin e detyrimeve financiare të pashlyera me qëllim shlyerjen e tyre në një kohë sa më të shpejtë. Fillimisht në muajin tetor 2013 u kontraktua një shoqëri e pavarur për të ndërmarrë një proces kontrolli dhe për të nxjerrë gjendjen përfundimtare në lidhje me kontratat qeveritare të pashlyera deri në fund të gushtit 2013. Detyrimet e prapambetura kontraktuale për investime, të identifikuara për institucionet e qeverisë qendrore, duke shtuar edhe pretendime të sipërmarrjeve, të cilat kërkojnë kontrolle të mëtejshme, vlerësohen të arrijnë 24.6 miliardë lekë. Këto vlerësohen të jenë vetëm një kategori e detyrimeve financiare të prapambetura. Detyrime të prapambetura janë identifikuar dhe në ndërmarrjet shtetërore të shërbimeve publike, ndaj subjekteve tatimpaguesve në procesin e rimbursimit të TVSH-së dhe tatim-fitimit, detyrime të krijuara si pasojë e vendimeve gjyqësore.

2. Nga vlerësimet paraprake, detyrimet e përgjithshme financiare të prapambetura të qeverisjes qendrore deri në dhjetor 2013 parashikohen të jenë afërsisht 72.6 miliardë lekë ose 5.3 për qind e PBB-së (shih tabelën 1 më poshtë). Kjo shifër do të jetë subjekt i verifikimeve të mëtejshme gjatë procesit të shlyerjes së detyrimeve. Përveç këtyre detyrimeve të prapambetura, mund të ketë edhe detyrime të tjera të konsiderueshme të prapambetura në sektorin më të gjerë publik, duke përfshirë ndërmarrjet shtetërore në sektorin e energjisë.

TABELA 1
NDARJA NË ZËRA E DETYRIMEVE TË PËRGJITHSHME FINANCIARE
TË PRAPAMBETURA TË QEVERISË

Vlerësimi paraprak i detyrimeve financiare të prapambetura	
	miliard lek
Detyrime për projekte investimesh	24.6
Detyrime për mallra dhe shërbime	5
Rimbursim i TVSH-së	12.84
Rimbursim i tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin	10
Detyrime për vendime gjyqësore ndërkombëtare	1
Të tjera (vendime gjyqësore, shpronësime publike, përfitimet për persona me aftësi të kufizuar etj.)	19.13
TOTALI	**72.57**

3. Pjesa e pashlyer e vlerësuar e pretendimeve financiare kundrejt qeverisë në tabelën 1 do të përditësohet për gjendjen që rezulton në datën 31 dhjetor 2013 dhe do të konfirmohet nëpërmjet një procesi verifikimi që do të kryhet nga titullarët e ministrive të linjës dhe krerët e njësive të tjera qendrore, nën

mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave (MF). Gjithashtu, në shtojcën 1 të këtij dokumenti strategjik jepet plani i veprimit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Ndikimi i detyrimeve financiare të prapambetura në ekonominë shqiptare

4. Paaftësia e një qeverie për të paguar detyrimet e saj financiare, brenda një kohe të shpejtë pasi ato bëhen të kërkueshme, dhe si pasojë dhe akumulimi i një mase të madhe të detyrimeve financiare të prapambetura i shkakton dëm ekonomisë. Ndikimet përfshijnë ngadalësimin e rritjes ekonomike dhe rritjen e papunësisë, për sa kohë bizneset e varura nga kontratat qeveritare pushojnë ose shtyjnë aktivitetin e tyre si rezultat i vonesave në pagesa ose vështirësive në mundësinë e kredive nga bankat tregtare. Shlyerjet e huave kundrejt bankave mund të vuajnë nëse likuiditeti kufizohet si rezultat i rritjes së detyrimeve të prapambetura. Ndikimet mbi likuiditetin në treg mund të jenë gjithashtu të ashpra. Këta faktorë mund të rezultojnë në një ndikim dëmtues mbi kërkesën e përgjithshme dhe mund të kufizojnë aftësinë e qeverisë në përdorimin e politikës fiskale si një mjet për stabilizimin makroekonomik. Nëse furnitorët e qeverisë marrin parasysh mundësinë e vonesave të gjata në marrjen e pagesave, ata mund të përpiqen të ulin riskun dhe koston shtesë të pagesave të vonuara duke rritur përkatësisht çmimet e tyre, duke detyruar kështu qeverinë të paguajë çmimet mbi tregun për shërbimet e ofruara.

5. Një pjesë e rritjes së huave të këqija në sektorin bankar në disa prej viteve të fundit mund t'u atribuohet detyrimeve të prapambetura të qeverisë. Dhënia e shërbimeve publike në disa raste është ndalur plotësisht pasi furnitorët kanë ndërprerë zbatimin e ndërtimit në projektet e investimeve për shkak të mospagesave, duke rezultuar në degradimin e disa investimeve, veçanërisht në sektorin rrugor. Së fundmi, në rastet e vonesave të pagesave të asistencës sociale ka një ndikim të drejtpërdrejtë në shtresat më të pambrojtura të shoqërisë, të cilat vuajnë si pasojë e vonesave në pagesat e përfitimeve.

6. Për pasojë, zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie për eliminimin e pjesës së detyrimeve të prapambetura dhe ndërmarrja e masave për të parandaluar akumulimin e mëtejshëm në të ardhmen do të jetë një hap i rëndësishëm i përpjekjeve të qeverisë për të rikthyer ekonominë te një rritje e fuqishme në të mirë të të gjithë qytetarëve brenda një periudhe afatmesme dhe afatgjatë, si dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të re partneriteti. Seksionet e mëposhtme të këtij dokumenti e shtjellojnë këtë strategji.

Përkufizimi i detyrimeve të prapambetura

7. Për qëllimet e Strategjisë së Parandalimit dhe Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura (SPSD), detyrimet e prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje/vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes qendrore, pushtetit vendor (kontratat e financuara nga qeveria qendrore) dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Balanca e verifikuar e pashlyer në datën 31 dhjetor 2013 (si dhe e papaguar gjatë muajit janar 2014) do të përdoret për qëllimin e strategjisë.

8. Në detyrimet e prapambetura të lindura në njësitë e qeverisjes vendore përfshihen vetëm detyrimet për punimet e kryera, por të papaguara në kuadër të financimeve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, si edhe transfertat për përfitimet e paaftësisë. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njësive të qeverisjes vendore, që nuk përfshihen në sa më sipër, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njësive të qeverisjes vendore.

B. Parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura në të ardhmen

9. Një shtyllë themelore e strategjisë është parandalimi i rikrijimit të detyrimeve të prapambetura. Për këtë qëllim, qeveria ka zhvilluar një analizë të shkaqeve të pagesave të vonuara dhe do të miratojë masa specifike për të forcuar disiplinën buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen e eficiencës së shpenzimeve. Zbatimi i suksesshëm i këtyre masave do të kërkojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave ligjore nga ana e titullarëve, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe stafit mbështetës të tyre. Sanksionet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi do të zbatohen në rastet e shkeljes së kërkesave ligjore e nënligjore. Masat për forcimin e disiplinës financiare përfshijnë:

9.1 Sigurimin e financimit të mjaftueshëm në vitin ushtrimor dhe në vitet në vazhdim përpara se të fillojë prokurimi, kjo bazuar në disponibilitetin e fondeve buxhetore për të gjitha detyrimet e marra përsipër nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

9.2 Si një masë e nevojshme kontrolli, regjistri i prokurimeve të depozitohet zyrtarisht dhe elektronikisht në degën e thesarit, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe çdo rishikim i tij gjatë vitit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor ose për

më shumë se një vit (për kontratat shumëvjeçare të investimeve).

9.3 Këshilli i Ministrave do të miratojë kufijtë shumëvjeçarë të angazhimeve, si pjesë të dokumentit të buxhetit afatmesëm dhe në vitin 2015 këta kufij do të miratohen nga Kuvendi si pjesë e ligjit të buxhetit vjetor, pas rishikimit të bazës ligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Mbi këtë bazë edhe respektimi i angazhimeve do të monitorohet dhe kontrollohet nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë (SIFQ).

9.4 Duke filluar nga janari 2014, të gjithë urdhrat e prokurimit për mallrat, shërbimet dhe investimet e nxjerra gjatë vitit, përveç blerjeve emergjente me vlerë nën 10,000 lekë, duhet: i) t'i përmbahen regjistrit të prokurimeve të dorëzuar në thesar; ii) të vulosen nga dega e thesarit të rrethit nëse ka fonde buxhetore në dispozicion të institucionit, përpara procedimit sipas rregullave të prokurimit publik. Për mallrat, shërbimet dhe investimet, për të cilat ka nisur procesi i tenderimit përpara hyrjes në fuqi të strategjisë, do të paraqitet kontrata në degën e thesarit, për t'u kontrolluar kundrejt fondeve disponibël dhe vulosur, përpara nënshkrimit të saj nga nëpunësi autorizues i njësisë. Dega e Thesarit refuzon me shkrim një urdhër prokurimi, apo kontratën si më lart, të pambuluar me fonde publike dhe për këtë njofton Agjencinë e Prokurimit Publik, e cila e publikon në faqen e internetit. Kjo iniciativë që i shërben forcimit të disiplinës kontraktuale do të publikohet gjerësisht në komunitetin e biznesit për të siguruar që furnitorët e mallrave dhe shërbimeve të qeverisë të jenë plotësisht në dijeni të kësaj kërkese, me qëllim që një kontratë qeveritare të konsiderohet ligjërisht e vlefshme.

9.5 Mundësimin e kontrollit të fazës së paraangazhimeve financiare dhe monitorimit të pagesave të pashlyera (duke rishikuar SIFQ për kontrollin e faturave kundrejt fondeve buxhetore vjetore dhe datat e pagesave kundrejt mjeteve monetare të qeverisë). Ministria e Financave ka filluar t'u sigurojë institucioneve të drejtën e përdorimit direkt të sistemit informatik financiar të qeverisë, i cili do të zgjerohet në të ardhmen duke mbuluar kështu 60 për qind të fondeve të buxhetit të shtetit dhe 15 për qind të buxhetit lokal për vitin 2014, dhe 80% të fondeve të buxhetit të shtetit në vitin 2015.

9.6 Monitorimin e akumulimit të detyrimeve të reja të prapambetura. Ministria e Financave do të zhvillojë një sondazh semestral, te ministritë kryesore, nëse ka detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra pas datës 1 janar 2014 dhe do të zhvillojë një analizë të periudhës së pretendimeve, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi.

9.7 Ndryshime në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjin për menaxhimin dhe kontrollin financiar, ligjin e prokurimeve dhe rregulloret e tyre përkatëse për të realizuar kontrollin e kërkuar dhe kërkesat e raportimit.

9.8 Zbatimin e planeve qeveritare për të forcuar menaxhimin financiar publik në nivelin e qeverisjes vendore, duke filluar nga shtatori 2014 dhe vendosja e kërkesës për njësitë e qeverisjes vendore për të raportuar për kontratat dhe kreditorët.

9.9 Rimbursimi nga sistemi i thesarit i tepricës kreditore të kërkueshme të TVSH-së pas datës 1 janar 2014, sipas procedurës së miratuar me udhëzim të ministrit të Financave.

C. Menaxhimi i procesit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura

10. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura do të menaxhohet në mënyrë transparente nëpërmjet një procesi të miratuar brenda kritereve të vendosura në këtë strategji. Ky proces do të fillojë pasi detyrimet financiare të prapambetura të jenë verifikuar rregullisht dhe masat institucionale për mbikëqyrjen e procesit të jenë miratuar.

Parashikimi buxhetor

11. Fondet e caktuara për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nuk janë pjesë e buxhetit të miratuar për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme. Buxheti për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura do të identifikohet dhe menaxhohet nga KDP-ja. Fondet buxhetore për çdo kategori miratohen nga ministri i Financave si zë më vete në buxhet dhe rrisin nivelin maksimal të shpenzimeve për çdo njësi të qeverisjes qendrore, mbështetur në masën e detyrimeve të prapambetura që shlyhen, si dhe saktësinë e inventarizimit të detyrimeve për çdo kategori. Parashikimet për vitet në vazhdim do të përfshihen në programin buxhetor afatmesëm. Pagesat e verifikuara dhe të rakorduara do të paguhen brenda një periudhe që nuk i kalon tri vite kalendarike.

TABELA 2
PARASHIKIMI BUXHETOR AFATMESËM

	2014	2015	2016	TOTALI
Shpërndarja e buxhetit (miliard lek)	35	20	17.57	72.57

Caktimi i prioriteteve dhe radha e pagesave

12. Parimet në të cilat do të mbështeten këto pagesa do të jenë në mënyrë transparente, proporcionale, të besueshme, realiste dhe të drejtë.

13. Radha e pagesave për secilën kategori të detyrimeve të papaguara do të ndjekë parimin e kohës së krijimit të detyrimit financiar edhe sipas sektorëve. Pagesat do të fillojnë nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave të dorëzimit, vlerësimit dhe aprovimit nga institucionet përkatëse, të dokumentacionit që vërteton kryerjen e punimeve/shërbimeve/dorëzimin e mallrave dhe/ose kërkesën për rimbursimin e TVSH-së, tatim-fitimit. Radha e pagesës do të ndryshojë vetëm nëse ka parregullsi në dokumentacion që kërkon verifikime të mëtejshme.

14. Rimbursimi i TVSH-së dhe tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin do të fillojnë gjatë vitit 2014. Pagesat e rimbursimeve, pas verifikimit, do të kryhen kundrejt fondeve buxhetore të miratuara për këtë qëllim dhe sipas parimit hyrje e parë dalje e parë, duke u bazuar në datën e paraqitjes së kërkesës nga subjekti tatimpagues në organin tatimor (data e protokollit të organit tatimor) pavarësisht se kur është vlerësuar dhe miratuar nga ky i fundit.

Procesi i verifikimit

15. Titullarët e njësive të qeverisjes qendrore sigurohen që të gjitha detyrimet financiare të prapambetura të jenë vlerësuar dhe verifikuar plotësisht përpara dërgimit të dokumentacionit për pagesë. Verifikimet bëhen duke respektuar radhën kohore të lindjes së detyrimit. Dokumentacioni i plotë duhet t'i paraqitet degës së thesarit nga nëpunësit autorizues për kontroll për çdo urdhër pagese, për t'u shqyrtuar më pas nga Komiteti i Detyrimeve të Prapambetura (KDP), siç shpjegohet më poshtë.

16. Detyrimet e lindura në qeverisjen vendore për punimet e papaguara për projektet e infrastrukturës vendore të financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, do të verifikohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përpara se nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes vendore të dërgojnë urdhërpagesën me dokumentacionin shoqërues pranë degës së thesarit.

17. Detyrimet e prapambetura në lidhje me pretendimet e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar do të trajtohen pas auditimit të borxhit nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe do të paguhen duke respektuar parimin që detyrimet më të vjetra financiare do të marrin prioritetin më të lartë.

18. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të verifikojë, para se të bëhen pagesat, që pretendimet e rimbursimit të TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin janë të vlefshme. Verifikimi dhe kontrolli do të kryhen bazuar në datën e paraqitjes së kërkesës nga subjekti tatimpagues në organin tatimor (data e protokollit të organit tatimor). Një grup ekspertësh i dedikuar do të ngrihet pranë Ministrisë së Financave për të siguruar minimizimin e riskut të abuzimeve në procesin e rimbursimit të TVSH-së.

19. Përveç kontrolleve të sistemit të thesarit, Kontrolli i Lartë i Shtetit do të verifikojë dokumentacionin mbështetës të një pjese të pretendimeve para pagesës në bazë të parimit të materialitetit dhe mënyrës së miratuar në memorandumin e nënshkruar midis Ministrisë së Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

20. Ministria e Financave mund të kontraktojë një auditor të jashtëm për të verifikuar pretendimet për detyrimet financiare, të cilat nuk janë miratuar për shkak të mospërputhjes së dokumentacionit. Pas verifikimit të këtyre detyrimeve ato përfshihen në listën e detyrimeve financiare për t'u shlyer dhe do t'u nënshtrohen të njëjtave procedura të miratimit dhe pagesës si me detyrimet e raportuara sipas pikës 15 të strategjisë.

Mbikëqyrja e procesit

21. KDP-ja krijohet dhe funksionon në Ministrinë e Financave me përbërjen si vijon:

Zëvendësministri i Financave - kryetar;

Nëpunësi i parë autorizues - anëtar;

Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit - anëtar

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Financiare - anëtar;

Drejtori i Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin - anëtar;

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve - anëtar.

Komiteti do të bëjë aprovimin përfundimtar të listës analitike të detyrimeve të prapambetura për t'u

shlyer sipas SPSDP-së. Detyrat e KDP-së jepen në shtojcën 2 të strategjisë. Kontrolli i Lartë i Shtetit do të ketë statusin e vëzhguesit në KDP, duke siguruar që procesi i përshkruar të respektohet për të gjitha pretendimet.

22. Pranë Ministrisë së Financave krijohet një njësi e posaçme teknike, e cila do të mbështesë KDP-në dhe nëpunësin e parë autorizues në menaxhimin e të dhënave të pretendimeve, për të siguruar që pretendimet e verifikuara të paguhen në një mënyrë transparente, të saktë, të besueshme dhe të mbështetura në dokumentacionin e plotë sipas kërkesave ligjore e nënligjore në fuqi. Detyrat e njësisë jepen në shtojcën 3 të strategjisë.

23. KDP-ja do të takohet mesatarisht një herë në dy javë për të shqyrtuar dhe për të miratuar urdhrat e verifikuara të pagesave. Për detyrimet e lindura në pushtetin vendor nëpërmjet mekanizimit të financimit nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, KDP-ja bashkërendon paraprakisht me Sekretariatin e Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, i cili propozon pranë KDP-së masën dhe nivelin e shlyerjes së detyrimeve.

Përgjegjësia e KDP-së do të jetë të sigurojë që kriteret e caktimit të prioritetit për pagesat e specifikuara në strategji të respektohen dhe procesi i verifikimit të jetë i plotë.

24. Menjëherë pasi KDP-ja të aprovojë një kërkesë për pagesë, pagesat do të trajtohen në degën e thesarit ku ushtron veprimtarinë institucioni, i cili është përgjegjës përpara ligjit për shlyerjen e detyrimit të marrë përsipër prej tij.

25 Para pagesës, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve do të verifikojnë që subjektet kontraktore, të cilat paguhen sipas strategjisë, nuk kanë detyrime tatimore kundrejt administratës tatimore qendrore. Në këto raste, subjekti do të njoftohet me shkrim që detyrimi i pashlyer do të paguhet duke marrë në konsideratë detyrimet tatimore të pashlyera dhe do t'i jepet mundësi për t'u shprehur.

26. Një audit ndërkombëtar do të angazhohet nga ministri i Financave për të ndërmarrë një auditim të plotë financiar të një ekzemplari të pagesave të bëra sipas strategjisë së shlyerjes. Objektivi i auditit do të jetë dhënia e një mendimi të pavarur profesional për një model pagesash të audituara, i cili do të përfshijë një mendim për përshtatshmërinë e shpenzimit dhe përputhshmërinë me marrëveshjet përkatëse ligjore dhe strategjinë e shlyerjes. Auditi do të raportojë mbi ekzemplarin e testuar, duke përfshirë çështjet që kanë ardhur në vëmendje të auditit, të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi vlefshmërinë e strategjisë së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura. Konstatimet e auditit për rastet e abuzimit me fondet publike do të rezultojnë në pezullimin e pagesave të tjera sipas strategjisë në pritje të hetimit.

Kryerja e pagesave

27. Pagesat për subjektet kontraktore do të bëhen pas njoftimit zyrtar nga DPT-ja dhe DPD-ja për detyrimet tatimore, si dhe aprovimit të listës analitike nga KDP-ja.

28. Të gjitha pagesat do të kryhen nëpërmjet sistemit të thesarit me transfertë të vlerës totale të detyrimit në llogarinë bankare të subjektit/individit.

29. Në rastet kur subjekti tatimpagues figuron me detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore, pagesa do të kryhet nga thesari për totalin e detyrimit financiar të prapambetur duke përdorur një nga mënyrat si më poshtë vijon:

a) Pas dhënies së garancisë bankare për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ana e subjektit tatimpagues;

b) Transfertë në një llogari bankare *escrow* kundrejt konsensusit për shlyerjen e detyrimeve tatimore, të shprehur me një marrëveshjeje midis Ministrisë së Financave, subjektit tatimpagues dhe Bankës së nivelit të dytë ku ka llogarinë subjekti.

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndërmjet kompanive në sektorin e energjisë

30. Këshilli i Ministrave miraton një plan të veçantë kohor të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura ndërmjet shoqërive në sektorin e energjisë.

Raportimi financiar

31. Informacioni financiar për pagesat e detyrimeve të prapambetura do të përditësohet çdo muaj dhe do të publikohet në faqen e internetit të MF-së me bazë mujore. Ky raport do të përfshijë gjendjen fillestare të verifikuar në zërat e tabelës 1, pagesat e bëra gjatë periudhës nga çdo institucion buxhetor, llojin e detyrimit financiar, përfituesin dhe balancën e verifikuar mbyllëse të mbetur.

32. Pagesat e bëra sipas kësaj strategjie për kontraktorët tregtarë/individët do të identifikohen (veçmas nga pagesat e rregullta të vitit buxhetor) dhe do të publikohen në faqen e internetit të Ministrisë së Financave

me bazë javore për qëllimet e transparencës. Nënkontraktorët dhe bankat e nivelit të dytë mund të përdorin informacionin e mësipërm për t'u siguruar që, shumat e kërkueshme nga kontraktorët kryesorë (nëpërmjet shlyerjeve të huave tregtare ose pagesat për punët e kryera sipas një marrëveshjeje nënkontraktuale), mund të paguhen nga kontraktori primar. Raporti do të përfshijë emrin e kontraktorit, datën origjinale të faturës dhe shumën e paguar.

SHTOJCA 1
PLAN VEPRIMI PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Masat	Aktiviteti	Afatet dhe institucioni përgjegjës
Përfundimi dhe përditësimi i listës së detyrimeve financiare siç figurojnë në llogaritë kontabël të njësive në datën 31 dhjetor 2013	- Përfundimi i inventarizimit dhe rakordimi i të dhënave për kontratat, urdhrat e gjykatës, të formës së prerë, përfitimet nga paaftësia dhe kategoritë e tjera të detyrimeve të prapambetura deri më 31 dhjetor 2013 - Ngritja e një njësie të specializuar për kohëzgjatjen e operacionit të shlyerjes për të mbështetur KDP-në në mbledhjen e të dhënave dhe për t'u ndërlidhur me institucionet - Krijimi i një baze të dhënash për detyrimet e prapambetura dhe përmbledhja e informacionit për KDP-në. Rakordimi i ndryshimeve të identifikuara me raportin e Deloitte-t - Hetimi i pretendimeve të kontraktorëve që nuk janë deklaruar nga ministritë në raportin e Deloitte-t - Sigurimi që vetëm pretendimet e vlefshme të identifikohen për pagesat e pashlyera të përfitimit nga paaftësia dhe përfshirja e tyre si detyrime të prapambetura - Miratimi/përpilimi i listës së detyrimeve të të rakorduara, të aprovuara për pagesë dhe përditësimi i vazhdueshëm pas shlyerjes	Të gjitha institucionet, 30 janar 2014 MF, shkurt 2014 MF, mars 2014 Çdo titullar institucioni Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë KDP, MF
Miratimi i draftligjit "Për pagesat e vonuara në transaksionet tregtare"	- Hartimi i draftligjit dhe miratimi në KM	Ministria e Ekonomisë Shkurt 2014
Krijimi i Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura me termat e referencës	- Krijimi i Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura për mbikëqyrjen e aktiviteteve sipas planit të veprimit dhe detyrave të përcaktuara në strategji (shtojca 1 dhe 2)	MF, shkurt 2014
Nënshkrimi i memorandumit midis Ministrisë së Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit	Nënshkrimi i memorandumit midis Ministrisë së Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit	shkurt 2014
Miratimi i termave të referencës për auditët ndërkombëtarë të jashtëm dhe ndërmarrja e procesit të prokurimit	- Miratimi i termave të referencës, objektit të punës dhe aktiviteteve të auditëve - Fillimi i procesit të prokurimit	MF / BE
Rakordimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit i kërkesave për përfshirjen e auditit në verifikimin paraprak të pagesave	- Miratimi i termave të referencës për shpalljen. - Miratimi i kritereve të punës për auditët (koha, cilësia) - Kontraktimi i auditëve	KLSH

Zbatimi i masave parandaluese	- Zhvillimi i një baze të dhënash për regjistrimin e urdhrave të prokurimit (në konsultim me Agjencinë e Prokurimeve Publike) - Hartimi i udhëzimit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe përcaktimi i formatit për raportimin e detyrimeve të prapambetura nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme - Përgatitja e ndryshimeve në kuadrin ligjor - Rikonfigurimi i SIFQ (prokurimi i ekspertizës teknike dhe zbatimi i ndryshimeve në sistem) për kontrollin e faturave dhe kontrollin e kontratave shumëvjeçare	Institucionet, APP, MF MF, shkurt 2014 MF, shtator 2014 30 qershor 2014

SHTOJCA 2
DETYRAT E KOMITETIT TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA

Objektivat

Qëllimi i Komitetit është mbikëqyrja e zbatimit të strategjisë së parandalimit dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në emër të Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave. Kjo do të sigurojë që detyrimet e prapambetura të paguhen në mënyrë të plotë, transparente, brenda një afati realist kohor dhe që të gjitha pretendimet të verifikohen. Komiteti do t'i raportojë direkt ministrit të Financave.

Përbërja

Komiteti i Detyrimeve të Prapambetura (KDP) do të përfshijë, ndërmjet të tjerash, zëvendësministrin e Financave (kryetari), nëpunësin e parë autorizues, Drejtorin e Përgjithshëm të Buxhetit, Drejtorin e Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve (për të vlerësuar detyrimet tatimore të subjekteve) dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimeve Financiare. Anëtarë të tjerë do të thirren sipas rastit. Kryetar i Komitetit do të bëjë aprovimin përfundimtar për pagesat. Kontrolli i Lartë i Shtetit do të jetë i pranishëm si vëzhgues.

Komiteti do të mbështetet nga një njësi speciale me detyrë, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave për pretendimet dhe paraqitjen e raporteve dhe dokumentacionit te KDP-ja.

Detyrat e Komitetit

KDP-ja do të mblidhet një herë në dy javë për ushtrimin e funksioneve të veta si vijon:

1. Sigurohet që është përgatitur një bazë e plotë të dhënash për detyrimet e prapambetura, siç figurojnë në datën 31 dhjetor 2013 dhe që të gjitha pagesat e përfshira në bazën e të dhënave përfshihen në përkufizimin e detyrimeve të prapambetura.

2. Monitoron dhe i raporton ministrit të Financave për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë (shtojca 1).

3. Merr raporte monitorimi nga nëpunësit autorizues dhe të sigurohet që pagesat kryhen sipas prioriteteve për pagesat të përcaktuara në strategjinë e shlyerjes dhe parandalimit.

4. Merr raporte/opinion nga thesari për cilësinë e dokumentacionit të dërguar nga nëpunësit autorizues.

5. Merr në konsideratë raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për verifikimin e plotësisë së dokumentacionit të pagesave para miratimit të tyre sipas memorandumit midis MF-së dhe KLSH-së.

6. Komiteti kërkon praninë e nëpunësve autorizues të ministrive të linjës në rastin e mosparaqitjes së të dhënave të përshtatshme mbështetëse.

7. Jep miratimin përfundimtar për listën analitike të detyrimeve të prapambetura që duhet të procesohen nga institucionet dhe sistemi i thesarit sipas strategjisë.

8. Monitoron zbatimin dhe efektivitetin e masave të parandalimit nëpërmjet raporteve periodike përmbledhëse nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore lidhur me angazhimet e reja gjatë vitit 2014.

9. Vë në dispozicion të auditit ndërkombëtar dokumentacionin e plotë ku bazohen pagesat e kryera.

10. Harton komentet formale për raportet e auditit ndërkombëtar dhe ndalon pagesat nëse ka dyshim në lidhje me legjitimitetin e pretendimit.

11. Çdo detyrë tjetër në lidhje me menaxhimin e procesit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura sipas kërkesës së ministrit të Financave.

SHTOJCA 3
DETYRAT E NJËSISË SË POSAÇME PRANË MINISTRISË SË FINANCAVE

Në Ministrinë e Financave do të ngrihet një njësi e posaçme për të mbështetur KDP-në, për të siguruar që të dhënat mbi detyrimet e prapambetura menaxhohen me efektivitet dhe që Komiteti të mbështetet mbi bazë ditore. Njësia mbështetëse e KDP-së kryen detyrat e mëposhtme:

1. Harton dokumentin për detajimin e fondeve buxhetore sipas kategorive të detyrimeve financiare dhe institucioneve, si dhe harton modelet e raportimit sipas strategjisë së shlyerjes dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura;

2. Përpunon dhe liston raportet e hartuara nga ministritë dhe institucionet qendrore mbi detyrimet e prapambetura, që do të përfshihen në strategjinë e shlyerjes, sipas kategorive dhe momentit kohor të krijimit të tyre (metoda hyrje e parë - dalje e parë).

3. Krijon, përditëson dhe ruan bazën e të dhënave për detyrimet e prapambetura, si dhe bashkërendon punën për buxhetimin e tyre si në vitin aktual ashtu edhe në vitet në vazhdim.

4. Në rast paraqitje të dokumentacionit të paplotësuar kryen ndjekjen e procesit direkt tek institucionet përgjegjëse deri në plotësimin e dokumentacionit.

5. Prezanton problematikat gjatë monitorimit të pagesave për t'u shqyrtuar nga KDP-ja, të shoqëruara me propozimet për zgjidhjen e tyre.

6. Kryen rolin e Sekretariatit të KDP-së dhe publikon vendimet e KDP-së.

7. Siguron publikimin e raporteve mbi bazë javore lidhur me pagesat e kryera, dhe mbi bazë mujore për fondet buxhetore të alokuara, pagesat e bëra gjatë muajit, detyrimet e pranuara për pagesë dhe balancën përfundimtare.

8. Siguron KDP-në që: i) secila pagesë është plotësisht e dokumentuar; ii) për të gjitha pagesat e kryera është marrë në konsideratë masa e detyrimeve tatimore që ka secili subjekt përfitues ndaj administratës tatimore qendrore; iii) si dhe evidentimi i tyre është bërë mbi bazë bruto sipas rregullimeve të kontabilitetit publik.

9. Mban kontaktet me auditin ndërkombëtar dhe KLSH-në dhe ofron dokumentacionin e kërkuar. Jep arsyet para KDP-së për dokumentacionin e munguar.

10. Monitoron procesin e parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura pas 1 janarit 2014, duke zhvilluar sondazhe semestrale te ministritë kryesore të linjës për të gjitha kontratat e investimeve, kontratat e mallrave dhe të shërbimeve me vlerë mbi 30 milionë lekë, si dhe ekzistencën e faturave të pashlyera nga muaji janar 2014.